

V E N D I M
Nr.461, datë 6.10.1999

**PËR MONITORIMIN E OBJEKTEVE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE A
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE, TË DHËNA ME QIRA OSE ENFITEOZË
PËRDORIMI I TË ARDHURAVE NGA QIRATË DHE ENFITEOZA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes, të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20. 4. 1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, me ndryshimet përkatëse dhe të ligjit nr.8333, datë 23.4.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit organizon monitorimin e kontratave, kur pasuria (ndërtesa, trualli e makineria) e ndërmarrjes, shoqërisë apo institucioni shtetëror jepet tërësisht me qira ose enfiteozë.

Struktura e njësisë monitoruese dhe funksionimi i saj përcaktohen me udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Detyrohen të gjitha institucionet, që, sipas përcaktimit të pikës 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998, kanë lidhur ose do të lidhin kontratë qiraje:

- Të dorëzojnë një kopje të këtyre kontratave në degën e shoqërive publike, në rrethin përkatës.

- Të dorëzojnë, pranë degëve të shoqërive publike të rretheve, një informacion 3-mujor, për derdhjet e qirave nga subjekte të ndryshme, përdorimin e të ardhurave nga qiratë, si dhe realizimin e kushteve të kontratës.

- Kontratat e lidhura nga çdo institucion para daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, të përsëriten pas skadimit të afatit, në përputhje me përcaktimet e vendimit në fuqi.

- Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, të vazhdojnë të monitorojnë kontratat e lidhura ndërmjet tyre dhe ish-AQRNB-së, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.8333, datë 23.4.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit” dhe para vendimeve e udhëzimeve në zbatim të tij, si dhe të dërgojnë, çdo 3-muaj, një informacion në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, për realizimin e detyrimeve kontraktore.

3. Të ardhurat që krijohen nga dhënia me qira apo enfiteozë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998 “Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive a institucioneve shtetërore”, të ndahen si vijon:

a.Për objektet e përfshira në shkronjën “a” të pikës 1:

- mbi 50 për qind buxheti i shtetit

- deri 50 për qind ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror, të cilët do t’i përdorin për:

- shlyerjen e debi-kredive dhe pagat;

- shpenzimet për riparime, përjashto punimet për mirëmbajtjen e përditshme.

b.Për objektet e përfshira në shkronjën “b” të pikës 1:

- mbi 40 për qind buxheti i shtetit;

- 10 për qind Ministria e linjës apo pushteti vendor, në varësi administrative të të cilit është ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror;

- deri 50 për qind ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror, të cilët do t’i përdorin për:

- shlyerjen e debi-kredive, pagat etj;

- shpenzimet për riparime, prjashto punimet për mirëmbajtjen e përditshme;
- zhvillimin e veprimtarisë ekonomike.
- c. Për objektet e përfshira në shkronjën “c” të pikës 1:
 - Kur jepet e tërë pasuria e ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror, të ardhurat nga qiraja ose enfiteoza ndahen si vijon:
 - * mbi 50 për qind buxheti i shtetit;
 - * deri 50 për qind Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, e cila i përdor si vijon:
 - për të mbuluar detyrimet e ndërmarrjes, të shoqërisë a institucionit;
 - për shpenzimet për pagat dhe shtesat mbi page të grupit monitoriues të kontratave;
 - për shlyerjen e tatimeve përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;
 - për të mbuluar shpenzimet për riparime, prjashto punimet për mirëmbajtjen e përditshme.
 - Kur jepet pjesërisht pasuria e ndërmarrjes, shoqërisë apo institucioni shtetëror me qira ose enfiteozë, të ardhurat ndahen si më poshtë:
 - mbi 50 për qind buxheti i shtetit;
 - * 10 për qind Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, e cila i përdor sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998;
 - deri 40 për qind ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror, të cilat i përdorin për:
 - të mbuluar detyrimet e ndërmarrjes, shoqërisë a institucionit;
 - shlyerjen e tatimeve përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;
 - të mbuluar shpenzimet për riparime, prjashto punimet për mirëmbajtjen e përditshme;
 - zhvillimin e veprimtarisë ekonomike, pagat etj.
- 4. Pika 7 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998 shfuqizohet.
- 5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko